

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9616, DATË
27.9.2006, "PËR LIBRIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" I
NDRYSHUAR,

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN

Qëllimi i përgatitjes së projektligjit të librit është mbështetja dhe promovimi i letrave shqipe brenda dhe jashtë vendit, hartimi dhe zbatimi i projekteve në ndihmesë të rritjes së kulturës së leximit, krijimi i një rrjeti bashkëpunues dhe mbështetës mes shkollës, familjes, institucioneve librare e bibliotekare, mbështetja e nismave për formimin e specialistëve të librit, nëpërmjet rishikimit të disa dispozitave të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, të cilat synojnë të pasqyrojnë ndryshimet e vazhdueshme të ndodhura në fushën e librit, t’i përgjigjet zhvillimeve të teknologjisë dhe digjitalizimit në fushës së botimeve, të korrigojë dhe të përmirësojë nene të tejkaluara që pengojnë përmirësimin e klimës së botimeve, t’u vijë në ndihmë krijuesve, botuesve dhe operatorëve që veprojnë në fushën e librit. Përmirësimet në këtë ligj, synojnë:

- a) përmirësimin e klimës së leximit dhe botimeve, uljen e çmimit të librit (nëpërmjet ndërhyrjeve për lehtësim në politiken fiskale të aplikuar për librin), që t’u vijë në ndihmë krijuesve, botuesve dhe operatorëve që veprojnë në fushën e librit, t’i përgjigjet zhvillimeve të teknologjisë dhe digjitalizimit në fushës së botimeve,
- b) përmirësim të ndjeshëm të afrimit dhe përhapjes së librit shqip brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe promocionit të tij në hapësira të ndryshme mediatike, kulturore dhe intelektuale, kudo ku lind dhe ndihet nevoja për literaturën e librit shqip dhe atij të përkthyer.
- c) përmirësimin e klimës së botimeve dhe distributionit në vend, lehtësimin e librit si produkt intelektual nga taksimi dhe ofrimi i mundësive dhe shanseve të barabarta për të gjithë komunitetin e botuesve, atë të shkrytarëve, përkthyesve, kritikës dhe studiuesve, veprat e të cilëve përveçse pasurojnë fondin e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore në fushën e librit, janë në vetvete edhe promotorë të zhvillimit dhe gjenerimit të vlerave dhe risive në këtë fushë.
- d) decentralizimin e politikës së librit nëpërmjet parashikimit të krijimit Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, e cila do të jetë një strukturë e posaçme që do të merret drejtpërsëdrejti me zbatimin e politikave/ projekteve dhe realizimin e objektivave për librin dhe krijuesit e tij në bazë të programit të Qeverisë Shqiptare dhe përparësive në këtë fushë të rëndësishme për kulturën e shkruar. QKLL-ja do të krijohet dhe funksionojë si një person juridik publik, buxhetor, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për

librin. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave (Ngritja e QKLL-së aktualisht po realizohet nëpërmjet hartimit të një projektvendimi, i cili është në fazën e bashkërendimit me institucionet e interesuara). QKLL do të funksionojë si organ zbatues i politikave në fushën e librit të hartuara nga Ministria përgjegjëse për librin. Kjo qendër do të ketë si objektive të saj themelore mbështetjen dhe promovimin e letrave shqipe brenda dhe jashtë vendit, hartimin dhe zbatimin e projekteve në ndihmesë të rritjes së kulturës së leximit, krijimin e një rrjeti bashkëpunues dhe mbështetës mes shkollës, familjes, institucioneve librare e bibliotekare për edukimin nëpërmjet leximit, mbështetjen e nismave për formimin e specialistëve të librit, të mësuesve, librarëve dhe bibliotekarëve të aftë për të përçuar dashurisë për librin, krijimin e një klime favorizuese për krijuesit, përkthyesit, botuesit dhe të gjithë operatorët që veprojnë në fushën e librit.

Objektivat kryesore të këtij projektligji janë:

- a) Heqjen e TVSH-së, gjë e cila do të lehtësojë të gjithë blerësit dhe lexuesit e librit në Republikën e Shqipërisë. Kjo do të ndihmojë jo vetëm shitësit e librit të cilët kanë paguar TVSH-në, shtëpitë botuese por edhe blerësit e librit, duke qenë se libri do të ketë kosto më të ulët prodhimi dhe si rezultat dhe një çmim më të lirë. Heqja e TVSH-së do të zbatohet për herë të parë jo vetëm për materialet e ofruara në format tradicionale por edhe për librin në formë elektronike, pavarësisht përmbajtjes së tij duke përfshirë dhe platformat elektronike (e-libri).
- b) Përjashtimi nga procedurat e prokurimit për blerjen e librit, për të pasuruar fondet e sistemit bibliotekar kombëtar me vepra me karakter kulturor, shkencor, teknik apo teknologjik të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Kjo politikë do të sillte dhe lehtësira për Bibliotekën Kombëtare dhe rrjetin e bibliotekave publike, dhe për t'ju përgjigjur kërkesave specifike të komunitetit;
- c) Lehtësimi nga numri i ekzemplarëve të kopjeve të detyruara që dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare dhe bibliotekat vendore, është një tjetër hap që ka për qëllim të reformojë dhe lehtësojë marrëdhënien ndërmjet botuesve dhe institucioneve të ruajtjes së kujtesës në vend, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standardeve bashkëkohore.

II. VLERËSIMI I PROJEKT LIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. . 9616, datë 27.9.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare, është parashikuar në vendimin nr. 246, datë 9.5.2018, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2018–2020” Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura", dhe angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Kulturës në kuadrin e hartimit dhe përmirësimit të akteve me fuqi ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu projektligji është parashikuar në “Strategjinë Kombëtare për

Kulturën 2019-2025”, dhe është pjesë e programit të përgjithshëm analitik për vitin 2018.

Ministria e Kulturës është angazhuar në përgatitjen e këtij projektligji, në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka në kompetencë, si organ përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare në fushën e librit dhe leximit. Hartimi i këtij akti u bë në përgjigje të kërkesave të grupeve të interesit, të botuesve, përkthyesve dhe shkrimtarëve.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Historiku dhe tradita librore në Shqipëri ka qenë e lidhur ngushtë me të drejtën e shqiptarëve për identitet, pavarësi dhe integrim, por ngritja dhe mbrojtja e kësaj kauze në nivel institucional, ka një përvojë relativisht të re në krahasim me fushat e tjera si arkeologjia, trashëgimia kulturore apo edhe disiplinat e tjera të artit dhe kulturës.

Në këtë aspekt, ndonëse fusha e librit pas rënies së regjimit komunist fitoi një përmasë të re dhe të synuar prej dekadash nga protagonistët e tij, Ministria e Kulturës mundi të krijonte të parën strukturë të veçantë të saj në vitin 1998, Drejtorinë e Librit. Përgjatë viteve të para të tranzicionit Ministria e Kulturës hartoi, dhe miratoi Ligjin Nr. 8576, datë 03.02.2000 Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar si edhe Ligjin Nr. 9616, datë 27. 09 2006, i ndryshuar, duke vijuar me përcaktimin mbi baza ligjore të Fondit Kombëtar për Librin, ngritjen e Këshillit Kombëtar të Librit dhe Nxitjes së Leximit si edhe Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, duke krijuar në këtë mënyrë hapësirat e duhura për transparencë e decentralizim për mbështetjen e botimeve, veprimtarive kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e librit dhe bibliotekave, si edhe frymën e partneritetit me strukturat homologe ndërkombëtare. Bazuar në legjislacionin e sipërcituar nën autoritetin e Ministrisë së Kulturës funksionojnë Këshilli Kombëtar i Librit dhe Nxitjes së Leximit dhe Këshilli Kombëtar i Bibliotekave, dy organe të nivelit sipëror që e ushtrojnë veprimtarinë dhe funksionalitetin e tyre pranë Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë. Këto akte ligjore kanë patur impakt pozitiv në kohë kur janë miratuar por nuk i përgjigjen zhvillimit dhe ndryshimeve të ndryshme në kohë.

Ndryshimet në përmbajtjen e ligjit Nr. 9616, datë 27. 09 2006, “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vijnë si një domosdoshmëri e kohës dhe e përshtatjes me problematikat dhe format e zhvillimit të veprimtarisë botuese dhe procesin krijues në fushën e librit. Mungesa e strukturave të posaçme që merren me politikën librore, si dhe nevoja e ndërhyrjeve në nr. 9616, date 27.9.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, për të krijuar lehtësira fiskale për shtëpitë botuese janë dy nga problemet kryesore me ndikim të drejtpërdrejtë në krizën e librit.

Amendimet e ligjit në fjalë pritet të sjellin përmirësimin e klimës së **botimit** dhe distribucionit në vend, lehtësimin e librit si produkt intelektual nga taksimi dhe ofrimi i mundësive dhe shanseve të barabarta për të gjithë komunitetin e botuesve, atë të shkrimtarëve, përkthyesve, kritikës dhe studiuesve, veprat e të cilëve përveçse

pasurojnë fondit e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore në fushën e librit, janë në vetvete edhe promotorë të zhvillimit dhe gjenerimit të vlerave dhe risive në këtë fushë.

Problemi që merret në shqyrtim është rënia e theksuar e interesit për librin, kriza e leximit kuptuar si varfërim kulturor, social dhe ekonomik i popullatës. Ky problem nuk ka karakter vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Libri dhe leximi prezantojnë instrumente themelore për rritjen e kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë të një vendi. Në Kushtetutën e Shqipërisë garantohet me ligj dhënia e mundësisë së çdo qytetari për të qenë i lirë, i barabartë, si dhe detyrimin për zhvillimin e shoqërisë dhe individit. Këto objektiva mund të arrihen vetëm nëpërmjet kapacitetit që kanë qytetarët e mirëinformuar për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për të qenë pjesëmarrës aktivë në jetën sociale dhe publike. Zhvillimi i shoqërisë ka nevojë për individë të përgatitur, por mbi të gjitha ka nevojë për një akses të lirë pa pengesa ndaj informacionit, kulturës dhe mendimit. **Afirmimi i vlerave të librit dhe të leximit nënkupton garantimin jo vetëm të rritjes kulturore, por edhe rritjen e ekonomisë dhe të punësimit.**

Nisur nga kjo premisë Amendimet ligjore synojnë të ndërhyjnë në disa drejtime:

- a) Heqjen e TVSH-së, gjë e cila do të lehtësojë të gjithë blerësit dhe lexuesit e librit në Republikën e Shqipërisë. Kjo do të ndihmojë jo vetëm shitësit e librit të cilët kanë paguar TVSH-në, shtëpitë botuese por edhe blerësit e librit, duke qenë se libri do të ketë kosto më të ulët prodhimi dhe si rezultat dhe një çmim më të lirë. Heqja e TVSH-së do të zbatohet për herë të parë jo vetëm për materialet e ofruara në format tradicionale por edhe për librin në formë elektronike, pavarësisht përmbajtjes së tij duke përfshirë dhe platformat elektronike (e-libri).
- b) Përfshirja nga procedurat e prokurimit për blerjen e librit, për të pasuruar fondet e sistemit bibliotekar kombëtar me vepra me karakter kulturor, shkencor, teknik apo teknologjik të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Kjo politikë do të sillte dhe lehtësira për Bibliotekën Kombëtare dhe rrjetin e bibliotekave publike, dhe për t'ju përgjigjur kërkesave specifike të komunitetit;
- c) Lehtësimi nga numri i ekzemplarëve të kopjeve të detyruara që dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare dhe bibliotekat vendore, është një tjetër hap që ka për qëllim të reformojë dhe lehtësojë marrëdhënien ndërmjet botuesve dhe institucioneve të ruajtjes së kujtesës në vend, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standardeve bashkëkohore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9616, datë 27.09.2006 ‘Për Librin në Republikën e Shqipërisë’”, është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht me nenet 78 dhe 83, pika 1.

Projektligji i paraqitur është në harmoni me gjithë rendin juridik të brendshëm e ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* E BASHKIMIT EUROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis* e Bashkimit Europian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Ky projektligj është i përbërë nga 25 nene.

- **Neni 1**, parashikon shtimin e fjalës “leximin”, në qëllimin e ligjit.
- **Neni 2**, përcakton gjithashtu si objekt të tij të drejtat e detyrimet e subjekteve ndërevepruese që kanë për objekt veprimtarie librin dhe produkte të përafërta me librin. Gjithashtu ky projektligj krijon kushtet për botimin e librave, përkthimet e autorëve, bashkëpunimin ndërkombëtar, koordinimin e të gjitha lidhjeve në zinxhirin e politikave të librit, trajnimin shtesë profesional dhe të specializuar në fushën e librit, si dhe të drejtën e huadhënies publike sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit dhe digjitalizimin në fushën e librave.
- **Neni 3**, bëhen disa shtesa dhe ndryshime të togfjalëshave, për një kuptim më të qartë të përkufizimeve përkatëse. Pika 1 e tij saktëson përkufizimin e “librit”. Pika 2 e saj qartëson ato që janë produkte të përafërta me të, duke qenë se nuk i përgjigjen zhvillimeve të kohës. Pika 3 referon në ligjin e ri të së drejtës së autorit, konkretisht nenit 127 të ligjit nr. nr.35/2016, date 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.
- **Neni 4 dhe 5**, parashikon zëvendësimin e emërimit të Kreut III të ligjit, duke qenë se parashikohen ngritja e organeve të reja në fushën e librit(QKLL), si dhe shtohet titulli i nenit, “*Këshilli Kombëtar i Librit dhe i Nxitjes së Leximit*”.
- **Neni 6**, një nen shumë i rëndësishëm, i cili parashikon ngritjen e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit(QKLL), si institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës, qendër e cila do t’i japë një ritëm tjetër dhe një frymë më intensive ecurisë dhe përmirësimit të situatës aktuale të botimeve, përhapjes së librit shqip brenda, dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe promovimit të tij në hapësira të ndryshme mediatike, kulturore dhe intelektuale kudo ku gjenerohet dhe ndihet nevoja për literaturën e librit shqip dhe atij të përkthyer
- **Neni 7**, bën zëvendësim të togfjalëshave për një kuptim më të qartë të ligjit.

- **Neni 8**, parashikon ndryshime të përbërjes së anëtarëve të KKLNL-së, duke shtuar numrin e anëtarëve të saj, për një përfaqësim sa më gjithëpërfshirës edhe të shoqatave të botuesve dhe krijuesve, si dhe personalitete të fushës, ku shtohen Drejtori i QKLL-së, 4 drejtues të shoqatave të botuesve dhe krijuesve, si dhe 3 anëtarë personalitete të njohura të fushës. Duke vlerësuar më të rëndësishëm përfaqësimin në këtë Këshill të grupeve të interesit që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me librin, është menduar shtimin e numrit të tyre duke hequr përfaqësimin nga Departamenti i Letërsisë dhe nga Akademia e Shkencave.
- **Neni 9**, përcakton se mënyra e funksionimit dhe organizmit të KKLNL-së, përcaktohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për librin. Pika 2 e saj parashikon se Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, shërben si sekretari tekniko-administrative në mbledhjet e KKLNL-së, e cila do të zëvendësojë strukturën administrative pranë Ministrisë së Kulturës.
- **Neni 10**, shfuqizon nenin 12 të ligjit, i cili parashikon se për nxitjen e botimit të veprave me rëndësi kombëtare, historike, kulturore e shkencore krijohet fondi kombëtar për librin, si zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Kulturës. KKLNL-ja, çdo vit, i propozon Ministrisë së Kulturës, titujt e veprave që do të botohen me mbështetjen e fondit kombëtar të librit. Kjo pasi fondi do të shkojë për QKLL_në.
- **Nenet 11**, parashikon heqje dhe zëvendësim të fjalëve, ku në pikën 5 të nenit 15 të ligjit, hiqet togfjalëshi “...nga Fondi Kombëtar i Librit”.
- **Neni 12**, parashikon zëvendësim të togfjalëshit Ministria e Kulturës, me Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, duke i kaluar kompetencën për të nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi dhe bashkëpunimi me operatorët radiotelevizivë, publikë ose privatë, si dhe me mediat e shkruara që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, për uljen e tarifave për reklamat, si dhe për krijimin e hapësirave për promovimin e botimeve të realizuara në Republikën e Shqipërisë.
- **Neni 13**, shton një nen të ri në fushën e ndërgjegjësimit dhe promovimit të programeve, nëpërmjet televizionit publik shqiptar për nxitjen e leximit. Ky propozim gjen mbështetje dhe është në harmoni me nenin 185, të ligjit “...nr. 35/2016, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to...”.
- **Neni 14**, shton një pikë në nenin 17 të ligjit duke parashikuar se blerja e librit nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit publik, për të pasuruar fondet e sistemit bibliotekar kombëtar me vepra me karakter kulturor, shkencor apo teknik duke krijuar institucionet fondet përkatëse në bazë të rekomandimeve të Këshillit Kombëtar të Librit dhe të Nxitjes së Leximit. Synohet lehtësimi për Bibliotekën Kombëtare dhe rrjetin e bibliotekave publike në Shqipëri nga procedura e prokurimit, në ato raste kur bëhet fjalë për blerjen e librave dhe materialeve të një rëndësie të veçantë që hyjnë në kategorinë e fondeve të rralla, të cilat në asnjë rast nuk mundet të tenderohen për vet specifikën e tyre. Libri nuk ka specifikime teknike dhe ekskluzivitetin e shtypjes dhe botimit e ka vetëm një shtëpi botuese, me çmim fiks.

- **Neni 15**, parashikon një nen të ri i cili vjen në ndihmë të shtypshkronjave dhe leximit të librave, në çdo lloj forme duke i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Ky parashikim zbatohet me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të nevojshme në nenin 53, pika j, të ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 46, të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr. 6, 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë.”.
- **Neni 16**, i kalon kompetencën e mbajtjes së të dhënave të regjistrit të botuesve, ku regjistrohen të gjithë botuesit e licencuar për ushtrimin e veprimtarisë botuese nga “MK-ja” tek “QKLL-ja”. Pika 2 po ashtu parashikon detyrimin e njoftimit nga shtëpitë botuese për regjistrimin e të dhënave kryesore pranë QKLL-së.
- **Neni 17**, shton si element që shënohet në çdo libër të botuar dhe të shtypshkruar në Republikën e Shqipërisë edhe “tirazhin (numrin e kopjeve)”, gjë e cila shmang informalitetin dhe ndihmon në respektimin e të drejtave të autorit. Gjithashtu shtohet si element detyrues edhe “numri i punonjësve të punësuar dhe niveli i arsimimit të tyre.”
- **Neni 18**, parashikon një saktësim nga ana procedurale, për sa i përket nënshkrimit të kontratës nga Agjencia Kombëtare e Standardizimit të ISBN-së
- **Neni 19**, heq si detyrim pagesën për Shërbimin për dhënien e ISBN-së nga Agjencia Kombëtare e Standardizimit të ISBN-së.
- **Neni 20** parashikon përveç Bibliotekës Kombëtare edhe bibliotekat publike pranë njësive administrative vendore, të cilat do të mbajnë kopje të botimeve sipas parashikimeve të nenit 41 të ligjit
- **Neni 21**, riformulon nenin 42 të ligjit, duke detyruar shtëpitë botuese që të dorëzojnë, pa shpërblim pranë Bibliotekës Kombëtare dhe bibliotekat publike pranë njësive vendore kopje për çdo botim të tyre, nga 3 (tri) kopje për çdo botim. Për tekstet shkollore ata detyrohen të dorëzojnë 3(tri) kopje për çdo botim të parë, dhe 2 (dy) për ribotimin, duke paguar edhe tarifën e shërbimit postar, kur është i nevojshëm”. Dy kopje pa shpërblim i dorëzojnë në bibliotekat publike pranë njësive vendore, ku ushtrojnë veprimtarinë, duke paguar edhe tarifën e shërbimit postar, kur është i nevojshëm.
- **Neni 22**, bën referim tek ligji i ri për të drejtën e autorit, hyrë në fuqi në tetor të 2016.
- **Neni 23**, parashikon shtimin e pikave 3 dhe 4 pas nenit 49, ku shprehet se hyrja në fuqi e nenit 18/1 të këtij ligji, i cili përjashton nga tatimi mbi vlerën e shtuar për furnizimin e shërbimeve të shtypshkronjave dhe materialet e ofruara në çdo lloj do të bëhet me ndryshimet në ligjin nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 46, të udhëzimit të Ministrit të Financave me nr. 6, 30.01.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. E njëjta procedurë do të ndiqet me përjashtimin që bëhet nga procedurat e prokurimit publik pasi të hyjnë në fuqi ndryshimet e nevojshme në ligjin nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar”.

- **Neni 24**, bën zëvendësimin kudo në ligj të togfjalëshit “*Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve...*” me togfjalëshin “*Ministri përgjegjës për politikën e librit dhe leximit*”.
- **Neni 25**, parashikon hyrjen në fuqi të këtij projektligji 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

*Me shkresën nr. 1531, datë 17.3.2017, Ministria e Kulturës ka dërguar për mendim projektligjin ministrive të linjës.

- ✓ MD-ja me shkresën nr. 1951/1, datë 7.4.2017, është shprehur me sugjerime të anës teknike dhe përmbajtjesore të projektligjit. MK-ja me shkresën nr. 1531/8, datë 14.6.2017, ka kthyer përgjigje ku shumica e sugjerimeve janë marrë parasysh dhe janë reflektuar, kurse disa të tjera që kanë të bëjnë me QKLL-në, tashmë ajo do të ngrihet me VKM dhe është në proces rakordimi me ministrinë.
- ✓ MF-ja me shkresën nr. 3848/3, datë 18.4.2017, shprehet me sugjerime sidomos për sa i përket analizës për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimeve të shërbimeve të shtypshkronjave dhe materialet e ofruara në formën tradicionale dhe çdo formë tjetër elektronike të librit, pavarësisht përmbajtjes së tij, që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë edhe platformat elektronike (e-libri), si dhe përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik të blerjes së librit në kuptim të nenit 17 të ligjit të librit. MF-ja ka bërë sugjerime edhe për QKLL-në, e cila tashmë ajo do të ngrihet me VKM dhe është në proces rakordimi me ministrinë.
- ✓ Ministri Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën nr. 1707/2, datë 4.4.2017 shprehet me 2 sugjerime, të cilat janë marrë parasysh me shkresën e MK-së nr. 2179, datë 13.4.2017.
- ✓ MZHETS me shkresën nr. 2986/1, datë 25.4.2017 shprehet parimisht dakord.
- ✓ Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin me shkresën nr. 1707/1, datë 3.4.2017 shprehet parimisht dakord.
- ✓ MAS me shkresën nr. 2872/1, datë 10.4.2017 shprehet parimisht dakord me disa sugjerime. MK-ja me shkresën nr. 3306, datë 23.5.2017 shprehet se merr parasysh disa sugjerime të anës teknike, por për anën përmbajtjesore shprehet me argumente se ato duhet të qëndrojnë në tekst siç është p.sh dorëzimi i 3 kopjeve të botimit të parë të teksteve shkollë pranë Bibliotekës Kombëtare, si dhe dorëzimi i 2 kopjeve të botimit të parë të teksteve shkollë pranë bibliotekave të njësive vendore pasi zbatohet vetëm për ata botues që ushtrojnë veprimtarinë në rrethet e tyre dhe i shërbejnë kujtesë lokale.
- ✓ MIE me shkresën nr. 646/1, datë 30.3.2017, nuk mund të shprehet pasi akti nuk synon përafrimin e legjislacionit me *acquis* e Bashkimit Europian.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e vetëqeverisjes vendore si dhe institucionet e varësisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Kulturës, konkretisht me urdhrin e grupit të punës nr. 222 date 4.07.2016, me anëtare ekspertë të fushës.

Gjithashtu janë ndjekur të gjitha etapat e konsultimit publik me grupet e interesit në respekt të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, sipas tabelës bashkëngjitur këtij relacioni, me të dhënat për procesin e njoftimit e të konsultimit publik. Projektligji është botuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, në faqen e Regjistrimit Elektronik të Konsultimit Publik (RENJK), janë mbajtura takime të përbashkëta, korrespondencë zyrtare nëpërmjet komunikimit elektronik me grupet e interesit etj. Janë marrë parasysh sugjerime të vlefshme të shoqatave botuese, shkrimtarëve e përkthyesve nëpërmjet komunikimeve zyrtarëve dhe takimeve konsultuese.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon efekte financiare.

Është parashikuar që ngritja e QKLL-së, e cila po realizohet nëpërmjet hartimit të projektvendimit përkatës, të mos shoqërohet me efekt shtesë financiar.

Burimet njerëzore të nevojshme për ngritjen e QKLL-së do të sigurohen prej ristrukturimit të Bibliotekës Kombëtare, dhe shkrirjes së Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit.

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI